

MEKANIZMI PËR ANKESA

Vendimet për financim të marra nga Ekipi për Vlerësimin e Granteve dhe që nuk vihen veto nga donatorët janë përfundimtare. Pas përfundimit të këtij procesi, KCSF-ja do t'i informojë aplikantët e pasuksesshëm me rezultatet e aplikimit të tyre, duke përfshirë pikët totale, pikët për kategori dhe renditjen përfundimtare. Informata të mëtejshme mund të ofrohen nga KCSF-ja vetëm me kërkesë, në formën e një përmbledhjeje të komenteve anonime nga anëtarët e Ekipit për Vlerësimin e Granteve.

Ankesa formale mund të paraqitet vetëm në rastet kur aplikantët e pasuksesshëm kanë arsye të forta për të besuar se një dokument specifik i dorëzuar nga ata është lënë jashtë procesit të vlerësimit, duke rezultuar në rezultate dukshëm më të ulëta në një kategori të caktuar ose në përgjithësi. Ankesa formale do të dorëzohet në bazë të shabllonit zyrtar të ankesës të publikuar në ueb faqen e KCSF-së brenda dy ditëve të punës pas njoftimit nga KCSF.

Drejtori Ekzekutiv i KCSF-së do të themelojë një komision të brendshëm për të vlerësuar nëse lëshimi i pretenduar ka ndodhur realisht, bazuar në dëshmitë e dorëzuara nga aplikanti i pasuksesshëm dhe në informatat që mund të gjurmohen nga sistemi i vlerësimit i KCSF-së. Në rast se komisioni i brendshëm konfirmon se lëshimi ka ndodhur realisht, dokumenti i hequr do të përfshihet në dosje dhe aplikacioni do të rivlerësohet nga EVG-ja dhe rezultati i ri që rezulton nga rivlerësimi do të përfshihet në renditjen përfundimtare të aplikantëve.